



## **INPO-Iniciativa për progresë**

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale  
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2016

**PËRMBAJTJA****FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT

BILANCI I GJENDJES

1

PASQYRA E TË ARDHURAVE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

3

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

4

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

6-17



## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

### Menaxhmentit të INPO

#### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të INPO. ("Organizata"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të Organizatës paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Organizatës më 31 Dhjetor 2016, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.

#### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

#### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së Organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

#### Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që Organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

**INPO****Pasqyra e pozitës financiare më 31 Dhjetor 2016**

		31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	Shënime	(në EUR)	(në EUR)
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe paisjet		-	-
Totali i pasurive jo-qarkulluese		<u>0</u>	<u>0</u>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		1,000	-
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	<u>26,182</u>	<u>15,640</u>
Totali i pasurive qarkulluese		<u>27,182</u>	<u>15,640</u>
<b>TOTALI I PASURIVE</b>		<u><b>27,182</b></u>	<u><b>15,640</b></u>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Llogaritë e pagueshme		1,000	-
Të hyrat e shtyera	5	<u>26,182</u>	<u>15,640</u>
Totali i detyrimeve afatshkurta		<u>27,182</u>	<u>15,640</u>
<b>Kapitali</b>			
Fitimi i mbajtur		-	-
Suficiti/(Deficiti) i periudhës		-	-
Totali i kapitalit		<u>-</u>	<u>-</u>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<u><b>27,182</b></u>	<u><b>15,640</b></u>

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në Mars 2018 nga:

**Albulena Nrecaj**

**Drejtoreshë ekzekutive**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

**INPO****Pasqyrat e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

---

		<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga subvencionet	<b>6</b>	<u>108,218</u>	<u>65,055</u>
<b>Totali i të hyrave</b>		<b>108,218</b>	<b>65,055</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e pagave	<b>7</b>	51,041	32,773
Aktivite të projekteve		20,920	9,989
Shpenzimet operative	<b>8</b>	11,949	8,558
Shërbime të kontraktuara	<b>9</b>	9,859	7,084
Shpenzimet e qerasë		8,297	6,650
Shpenzime për web dhe software	<b>10</b>	<u>6,152</u>	<u>-</u>
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>108,218</b>	<b>65,055</b>
<b>Suficiti/ (Deficiti) i periudhës</b>		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

---

**INPO****Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

---

	<b>Fitimi e mbajtura (në EUR)</b>	<b>Total Rezervat (në EUR)</b>
<b>Gjendja fillestare me 01 Janar 2015</b>	-	-
Suficiti/ (Deficiti) i periudhës	-	-
<b>Bilanci me 31 Dhjetor 2015</b>	<u>-</u>	<u>-</u>
<b>Gjendja fillestare me 01 Janar 2016</b>	-	-
Suficiti/ (Deficiti) i periudhës	-	-
<b>Bilanci me 31 Dhjetor 2016</b>	<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

---

**INPO****Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

---

	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>Fundi i vitit 31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese</b>		
Fitimi/Humbja para tatimit	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlersimin	-	-
Të hyrat e shtyera	10,542	6,623
Llogaritë e arkëtueshme	(1,000)	-
Llogaritë e pagueshme	1,000	-
<b>Paratë e gjeneruara nga operacionet</b>	<b>10,542</b>	<b>6,623</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	-	-
<b>Paraja neto e përdorur në investime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent</b>	<b>10,542</b>	<b>6,623</b>
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	15,640	9,016
<b>Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor</b>	<b>26,182</b>	<b>15,640</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare



## INPO

### Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016

#### 1. INFORMATAT E PERGJITHSHME

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparences dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike. Vizioni dhe misioni i organizatës përbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik. INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara për agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të mirë dhe më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe llogaridhënien e zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në instiucionet publike. Organizata është vlerësuar shumë për profesionalizmin e saj dhe qasjen e paanshme dhe ka arritur rezultate të shumta konkrete gjatë 12 viteve të operimit dhe përvojës.

#### 2. ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

##### 2.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNRF 5	Asetet-jo që mbahen për tu shitur dhe për operacione jot ë vijueshme-Ndryshime në metodat e eliminimit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
SNRF 7	Instrumentet Financiare: Paraqitja - Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
SNRF 14	Rregullatorë të llogarive të shtyera	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 10	Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNRF 11	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit – udhëzues i Tranzicionit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016

**INPO****Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

Amandament në SNRF 12	Dhënia e informacioneve shpjeguese tek subjektet tjera të interesit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 1	Prezentimi i pasqyrave financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 16	Sqarime të metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 19	Benefitet e punëtorëve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 27	Ndryshime për të rivendosur metodën e ekuitetit si opSION kontabël në pasqyrat e ndara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 28	Ndryshimet në lidhje me shitjen ose kontributin e aseteve në mes të një investitori, bashkëpunëtori apo joint venture	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
SNK 34	Raportimi në gjysëm periudhë-Dhënie informacionesh shpjeguese në vende të tjera në raportin financiar të gjysëm periudhës	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 38	Asetet e paprekshme	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandament në SNK 41	Impiantet bartëse	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016
Amandamente në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Janar 2016
Amandamente në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2012-2014) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2014

**INPO****Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

	(SNRF 2, SNRF 2, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	
Amandamente në standarde të ndryshme	Përmirësimet në SNRF (të ciklit 2011-2013) - që rezultojnë nga Projekti i Përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin	periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 Korrik 2014

**2.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë**

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNRF 2	Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave të ndara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 9	Instrumentet Financiare	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018
SNRF 15	Të ardhurat nga kontratat me klientët	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
SNRF 16	Qeratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
Amandament në SNK 12	Njohja e tatimeve të shtyra për Humbjet e porealizuara	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017
Amandament në SNK 7	Iniciativa të shpalosjeve	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017

Biznesi ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Biznesi parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

## **INPO**

### **Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016**

---

## **3. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL**

### **3.1 Baza e matjes**

Pasqyrat financiare për INPO janë përgatitur në bazë të matjeve të përcaktuara me SNRF për secilin lloj të pasurisë, të përgjegjësisë, të ardhurave e shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

### **3.2 Valuta e përdorur**

Valuta funksionale e INPO është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

### **3.3 Politika të rëndësishme kontabël**

Një përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare është paraqitur më poshtë:

#### **3.3.1 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shumë se tre muaj. INPO ka llogaritë e saj bankare të hapura në ProCredit Bank Sh.a.

#### **3.3.2 Njohja e të hyrave**

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhet. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

#### **3.3.3 Prona, impiantet dhe pajisjet**

INPO paraqet të gjitha pajisjet e blera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Andaj ato nuk kapitalizohen dhe as nuk zhvlerësohen.

#### **3.3.4 Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet e ndodhura për gjenerimin e të hyrave njihen në atë periudhë me kostot historike.

#### **3.3.5 Tatimet**

INPO u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

**INPO****Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016****4. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ**

<b>Paraja e gatshme</b>	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
Paraja në bank - ProCredit	18,759	4,899
Paraja në bank - ProCredit	6,575	9,273
Paraja në bank - ProCredit	865	-
Paraja në bank - ProCredit	290	137
Paratë në arka	(308)	1,331
<b>Totali i parasë së gatshme</b>	<b>26,182</b>	<b>15,640</b>

**5. TË HYRAT E SHTYERA**

<b>Të hyrat e shtyera</b>	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
Të hyrat e shtyera nga KCSF	18,385	-
Të hyrat e shtyera nga KFOS	7,252	8,685
Të hyrat e shtyera nga ATRC-USAID	487	-
Të hyrat e shtyera nga Instituti GAP	57	-
Të hyrat e shtyera nga MOTT	-	5,969
Të hyrat e shtyera nga Komuna e Prishtinës	-	985
<b>Total të hyrat e shtyera</b>	<b>26,182</b>	<b>15,640</b>

**6. TË HYRAT NGA SUBVENCIONET**

<b>Të hyrat nga subvencionet</b>	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
Të hyrat nga The Charles Stewart Mott Foundation	41,376	29,713
Të hyrat nga ATRC & USAID	36,661	6,340
Të hyrat nga Kosovo Foundation for Open Society	10,668	20,739
Të hyrat nga KCSF	10,215	-
Të hyrat nga Ambasada Austriake	2,490	-
Të hyrat nga komuna e Prishtinës	1,985	1,015
Të hyrat nga komuna e Ferizajit	1,980	-
Të hyrat nga Instituti GAP	1,943	-
Të hyrat nga Platforma Civikos	900	800
Të hyra tjera	-	628
Të hyra nga Nisma per aktivizim	-	3,000
Të hyrat nga Friedrich Ebert Stiftung FES	-	2,820
<b>Total të hyrat nga subvencionet</b>	<b>108,218</b>	<b>65,055</b>

**INPO****Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2016****7. SHPENZIMET E PAGAVE**

	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Shpenzimet e pagave</b>		
Shpenzimet e pagave	44,224	32,773
Kordinatorët regional	6,816	-
<b>Totali i shpenzimeve të pagave</b>	<b>51,041</b>	<b>32,773</b>

**8. SHPENZIMET OPERATIVE**

	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Shpenzimet operative</b>		
Shpenzimet per printim dhe fotokopje	4,396	3,632
Shpenzimet per udhetime	3,581	2,254
Shpenzimet per telefon	3,124	1,729
Furnizime për zyre	848	943
<b>Totali i shpenzimeve administrative</b>	<b>11,949</b>	<b>8,558</b>

**9. SHËRBIME TË KONTRAKTUARA**

	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Shërbime të kontraktuara</b>		
Shërbime të jashtme kontraktuale	9,566	6,837
Shërbime të kontabilitetit	292	247
<b>Totali i të hyrave nga shitjet</b>	<b>9,859</b>	<b>7,084</b>

**10. SHPENZIMET PËR WEB DHE SOFTWARE**

	<b>31 Dhjetor 2016 (në EUR)</b>	<b>31 Dhjetor 2015 (në EUR)</b>
<b>Shpenzimet për web dhe software</b>		
Web dhe databazë	3,764	-
Pajisje	2,388	-
<b>Totali i shpenzimet për web dhe software</b>	<b>6,152</b>	<b>-</b>

**11. PALËT E NDËRLIDHURA**

Për qëllime të këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të ndërlidhura nëse njëra prej tyre ka mundësinë të kontrolloj palën tjetër, apo nëse njëra prej tyre ka ndikim në palën tjetër gjatë marrjes së vendimeve financiare apo operuese sic është cekur në SNK 24 (standardet ndërkombetare të kontabilitetit) "Shpalosja e palëve të ndërlidhura". Në vështrimin e mundësisë së ekzistimit të palëve të ndërlidhura, vëmendja është përqëndruar në aspektin e marrëdhënies e jo në aspektin legal.

**12. MENAXHIMI I RISKUT*****Risku i Kreditimit***

Risku i kreditimit është risku që njëra palë me dështimin në përmbushjen e obligimeve financiare do ndikojë në palën tjetër të ketë humbje financiare. INPO nuk i është ekspozuar kredit riskut në aspektin e të hyrave nga donatorët.

***Risku nga kamatat***

INPO momentalisht nuk i është ekspozuar riskut nga kamatat bankare.

***Risku nga këmbimet ndërkombëtare***

INPO nuk i është ekspozuar rrezikut nga këmbimet ndërkombëtare pasi që transaksionet ndodhin në valutë vendore.

***Risku i likuiditetit***

Risku i likuiditetit paraqet riskun kur pjekuria e pasurisë dhe e detyrimeve nuk përputhen. INPO monitoron likuiditetin e sajë në baza periodike, në mënyrë që të menaxhoj obligimet e sajë në momentin kur duhet të paguhen.

***Vlera e drejtë e instrumenteve financiare***

Vlera kontabël e të gjitha aseteve dhe detyrimeve financiare të reflektuara në pasqyrat financiare përfaqësojnë me vlerën e tyre reale.